

VENDIM
Nr.944, datë 26.8.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË KOMUNËS PAPËR TË QARKUT TË ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Papër të qarkut të Elbasanit, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Papër të qarkut të Elbasanit, miratuar me vendimin nr.728, datë 7.11.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Papër, të qarkut të Elbasanit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Papër për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Papër

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-14	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
15-17	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
18-24	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
25-45	Varrezat publike	Në pronësi
46-58	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në mbrojtjen civile.	Në pronësi
63-69,128-130,136-137,139-140,143-145,148-151,288-292,338-341,390-396	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në zhvillimin ekonomik.	Në pronësi
342-344,348-350,352-354,357-359,361-367,369-375,378-380,384,386-388,191	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
346,347,351,356,360,368,376,377,382,383,385,389,345,355,381,545,549,552,558,561,562-656 (vetëm kanalet e treta)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
670-744,745-783,786-829,832-	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi

1022,1024-1057		
----------------	--	--